



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.
më _____.____.2020

Elbasan,

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: “Vassa” sh.p.k me adrese: lagjja “Kryengritja e Fierit”, Fier.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale elektrike për Agjensinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit 7,637,957 (shtatëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa t.v.sh., vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020 dhe 2021. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Shumatorja e çmimeve për njësi: 131,121 (njëqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e njëzet e një) lekë pa tvsh.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-62212-06-23-2020

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Maliq Haka” p.f me Nipt: L 32829201 A

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është **75,945** (shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekë (pa tvsh).

2. “Vassa” sh.p.k me Nipt: J 62903470 T

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është **76,183** (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Maliq Haka” p.f me Nipt: L 32829201 A

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertuesi “Maliq Haka” p.f, skualifikohet për arsye se: Ky operator kishte mangësi në dokumentacionin e paraqitur e konkretisht:

1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi kjo e vërtetuar nëpërmjet dokumentave orgjinal ose të noterizuar si përfaqësues i kompanisë prodhuese për të gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë në letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri, ka paraqitur një autorizim nga A.Davleris S.A. i cili është në gjuhën angleze dhe jo shqipe, "Bazuar ne seksionin 4 te DST, specifikisht pika 4.6 , gjuha e perzgjedhur per hartimin e dokumentave te tenderit eshte shqipja, prandaj cdo dokumentacion i paraqitur nga OE duhet te jete ne perputhje me gjuhen e zgjedhur, ose ne gjuhe te huaj , i perkthyer dhe i noterizuar sipas legjislacionit ne fuqi."

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

2. Në pikën 2.3.4 te Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri , nuk ka paraqitur asnjë katalog të mallrave objekt prokurimi.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me këtë kriter.

3. Në pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Për materialet (automat, çelësa, priza, tela, kabëll) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportin e testimit i cili duhet të jetë kryer nga laboratorë testues të çertifikuar me ISO 17025:2005 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri , ka paraqitur një raport testimi vetëm për celesat dhe prizat, por që nuk është kryer nga laboratorë testues të certifikuar me ISO 17025:2005 ose ekuivalente nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare të akreditimit.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me këtë kriter.

4. Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar pikën 6 të Shtojcës 2/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur.

5. Operatori Ekonomik në përmbushje të pikes 2.3.9 te Kapacitetit Teknik të DST ka paraqitur mostrat e kërkuara nga AK, por për elementin : Lamba 250 W të Bardha 3800 Kelvin, OE ka dorëzuar një llambe 250 W të Bardha 4000 Kelvin, si dhe për elementin Pllaketa LED 100 W, ka dorëzuar një pllaketë të cilës nuk i përputhet kodi sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Kjo e dokumentuar me proces-verbal të mbajtur ditën e dorëzimit të mostrave.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me këtë kriter.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]”

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Vassa” sh.p.k me Nipt: J 62903470 T

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **76,183** (shtatëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) **lekë** (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 30.07.2020

Ankesa: nuk ka pasur

KONTRAKTOR

TITULLARI I AUTORITETIT

PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Irland Sina